



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4924 prot.

Himarë, më 02.07.2025

## VENDIM

Nr. 28 , Datë 27.06.2025

**“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE  
PREJ 3HA NË PALASË, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË “DULLA  
KONSTRUKSION”SH.P.K”**

**AKTIVITETI:**

**“INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE”**

Bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive" pika 49 ; Ligjit 57/2020, date 30.04.2020 "Për Pyjet", neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; VKM nr. 1030, datë 16.12.2015 “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike” (FPPMIS), pikes 1, kreu II, “Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, objekte, truall, tokë bujqësore, pyll, livadhe dhe kullota, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njëjësive të qeverisjes vendore”; Vendimit të KIS (Komiteti i Investimeve Strategjike) Nr. 20/15, date 06.06.2023, pika 11; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, këshilli bashkiak pasi shqyrtoi materialin e miratoi me pesëmbëdhjetë ( 15 ) vota pro , katër ( 4 ) kundër, zero ( 0 ) abstenim dhe si më poshtë,

## **VENDOSI:**

1. Dhënie e miratimit për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 3 ha në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë “DULLA KONSTRUKSION” sh.p.k., për aktivitetin “INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE”.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për ngritjen e urdhrave përkatës për zbatimin dhe ndjekjen e të gjithë hapave pproceduriae ligjorë të këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

**KRYETARI**

**Dhimitër Kapaj**

